



VENDIM

Nr. 78, Datë 26.05.2017

**MBI
MIRATIMIN E KONTRATËS PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE TË
ZYRTARIT TË PËRPUTHSHMËRISË NË SEKTORIN E GAZIT
NATYROR.**

Në mbështetje të neneve 16, pika 7 dhe 47 pika 2 të Ligjit Nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror” dhe neneve 15 dhe 26 të “Rregullave të Organizimit, Funksionimit dhe Procedurave të ERE”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr.96, datë 17.06.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 26.05.2017, mbasi shqyrtoi relacionin dhe draftin e përgatitur nga Drejtoritë Teknike të Kontratës për Ofrimin e Shërbimeve të Zyrtarit të Përputhshmërisë,

Konstatoi,

1. Ligji Nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror” nën 47 pika 2 përcakton se:

47.2. Zyrtari i përputhshmërisë emërohet nga këshilli mbikëqyrës ose, nëse një organ i tillë nuk është formuar, nga organi kolektiv i menaxhimit të OST-së, pas miratimit paraprak nga ERE. ERE mund të refuzojë miratimin e zyrtarit të përputhshmërisë vetëm për arsye të mungesës së pavarësisë apo kapaciteteve profesionale. Zyrtari i përputhshmërisë mund të jetë një person fizik ose juridik, i pavarur në punën dhe veprimet e tij ose të saj.

47.3. ERE miraton kriteret dhe detyrat për pozicionin e zyrtarit të përputhshmërisë, si dhe afatin e qëndrimit në detyrë. Këto kritere kanë qëllim të sigurojnë pavarësinë e zyrtarit të përputhshmërisë dhe burimet e nevojshme për përmbushjen e detyrave të tij.

2. Enti Rregullator i Energjisë me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr.26 datë 15.02.2017, vendosi fillimin e procedurave “Për Miratimin e Kontratës për Ofrimin e Shërbimeve të Zyrtarit të përputhshmërisë”.

3. Mbas marrjes se vendimit për fillimin e procedurave cituar me lart, Enti Rregullator i Energjisë vijoi me procesin e konsultimit të Draft-Kontratës me palët e interesuara të cilat kanë paraqitur opinion në ERE si më poshtë:

a) Autoriteti i Konkurrencës me shkresën nr.82/1 datë 21.03.2017 protokolluar me tonën nr.183/1 datë 24.03.2017 shprehet :

Komisioni i Konkurrencës në mbledhjen e datës 21.03.2017, mori në shqyrtim projekt Kontratën dhe shprehet se: Projekt “Kontrata për Ofrimin e Shërbimeve të Zyrtarit të Përpuethshmërisë”, nuk bie në kundërshtim me ligjin Nr.9121, datë 21.03.2017 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.

b) Gjithashtu Sekretariati i Komunitetit të Energjisë në datën 10.03.2017 në kontakt në postën zyrtare të ERE-s erealb@ere.gov.al, shpreh se;

Nuk ka ndonjë vërejtje në lidhje Draft-Kontratën për ofrimin e shërbimit të Zyrtarit të përpuethshmërisë. Sekretariati i Energjisë shpreh dakordësinë e tij për të vazhduar më tutje .

Për gjithë sa më sipër Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Miratimin e Kontratës për Ofrimin e Shërbimeve të Zyrtarit të Përpuethshmërisë në sektorin e Gazit Natyror.
2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e Bordit të ERE-S.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative.

brenda 45 ditëve nga botimi ne Fletoren Zyrtare .

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.



REPUBLIKA E SHQIPERISE
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE
Bordi



Votimi i Bordit të ERE-s për,

VENDIM

Nr. 78, Datë 26.05.2017

**MBI
MIRATIMIN E KONTRATËS PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE TË
ZYRTARIT TË PËRPUTHSHMËRISË NË SEKTORIN E GAZIT
NATYROR.**

Anëtarët e Bordit

	Pro	Kundër
Petrit Ahmeti	_____	_____
Adriatik Bego	_____	_____
Entela Shehaj	_____	_____
Abaz Aliko	_____	_____
Maksim Shuli	_____	_____

KONTRATË

PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE TË ZYRTARIT TË
PËRPUTHSHMËRISË

Nr [●]

[●] [●] [2017], [Tiranë]

[*Emri i OST*], një kompani e ngritur në mënyrë të vlefshme dhe që funksionon në bazë të ligjeve të Republikës së Shqipërisë, regjistruar me numër regjistrimi Nr [●], me zyra qendrore [●] (këtu dhe më poshtë – “OST”), e përfaqësuar rregullisht nga [Drejtori i Përgjithshëm] [●], që vepron [*në bazë të një mandati/ autorizimi*], dhe

{ALTERNATIVA A}¹ [*Emri i Zyrtarit të Përputhshmërisë*], një kompani e ngritur në mënyrë të vlefshme dhe që funksionon sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, regjistruar me numër regjistrimi Nr [●], me zyra qendrore [●] (këtu dhe më poshtë – “Zyrtari i Përputhshmërisë”), e përfaqësuar rregullisht nga [Drejtori i Përgjithshëm] [●], që vepron [*në bazë të një mandati/ autorizimi*],

{ALTERNATIVA B}² [*Emri dhe mbiemri i Zyrtarit të Përputhshmërisë*], numri personal [●], adresa e banimit [●] (këtu dhe më poshtë – “Zyrtari i Përputhshmërisë”),

këtu dhe më poshtë në mënyrë të përmbledhur ju referohemi si “Palët” dhe secilit në mënyrë të veçantë si “Pala”, duke marrë parasysh:

- **{ALTERNATIVA A}**³ OST do të autorizohet për transmetimin e gazit natyror dhe do të certifikohet si operator i veçuar i sistemit të transmetimit për gazin natyror sipas termave dhe kushteve të përcaktuara në Ligjin Nr. 102/2015 “Për

¹ **Sekretariati i Komunitetit të Energjisë:** Duhet të plotësohet nëse është e domosdoshme që Zyrtari i Përputhshmërisë të jetë një *person juridik*. Ju lutem fshijeni nëse nuk është e përshtatshme.

² **Sekretariati i Komunitetit të Energjisë:** Duhet të plotësohet nëse është e domosdoshme që Zyrtari i Përputhshmërisë të jetë një *person fizik*. Ju lutem fshijeni nëse nuk është e përshtatshme.

³ **Sekretariati i Komunitetit të Energjisë:** A duhet të nënshkruhet Kontrata *para* autorizimit dhe certifikimit të OST. Ju lutem fshijeni nëse nuk është e përshtatshme.

Sektorin e Gazit Natyror” dhe akteve të tjera ligjore në fuqi;

- **{ALTERNATIVA B}**⁴ OST autorizohet për transmetimin e gazit natyror sipas licensës Nr [●] lëshuar nga Enti Rregullator i Energjisë (këtu dhe më poshtë – “ERE”) datë [●] dhe është certifikuar si operator i veçuar i sistemit të transmetimit për gazin natyror sipas Vendimit të Bordit të ERE Nr [●] datë [●];
- OST e caktoi Zyrtarin e Përputhshmërisë me miratimin e Vendimit Nr [●] të [organeve përkatëse] të kompanisë OST datë [●] dhe miratuar me Vendimin e Bordit të ERE Nr [●] datë [●];
- Kandidimi i Zyrtarit të Përputhshmërisë është miratuar nga ERE sipas Vendimit të Bordit Nr [●] datë [●]; dhe
- Zyrtari i Përputhshmërisë është emëruar nga [organet përkatëse]⁵ të kompanisë OST bazuar në Vendimin e saj Nr. [●] datë [●],

Kanë lidhur këtë Kontratë për Ofrimin e Shërbimeve të Zyrtarit të Përputhshmërisë (këtu dhe më poshtë – “Kontrata”) sipas termave dhe kushteve të mëposhtme.

1. SUBJEKTI I KONTRATËS

- 1.1. Nëpërmjet kësaj Palët bien dakord që Zyrtari i Përputhshmërisë duhet të ofrojë shërbimet e tij për kompaninë OST duke vepruar brenda kompetencave dhe sipas mandatit të vendosur sipas Ligjit Nr 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror” (këtu dhe më poshtë – “Ligji”), akteve të tjera ligjore në fuqi, Programit të Përputhshmërisë dhe kësaj Kontrate, ndërkohë që OST duhet të sigurojë zbatimin e masave të nevojshme për Zyrtarin e Përputhshmërisë që ai të jetë në gjendje të sigurojë shërbimet e tij dhe duhet të paguaje për këto shërbime.
- 1.2. Programi i Përputhshmërisë duhet të bashkëlidhet në [Shtojcën I] të kësaj Kontrate dhe duke nënshkruar këtë Zyrtari i Përputhshmërisë konfirmon që ai i kupton dhe është dakord dispozitat e Programit të Përputhshmërisë, natyrën e tij kufizuese, detyrimet dhe të drejtat e Zyrtarin e Përputhshmërisë, dhe efektet për

⁴ **Sekretariati i Komunitetit të Energjisë:** A duhet të nënshkruhet Kontrata pas autorizimit dhe certifikimit të OST. Ju lutem fshijeni nëse nuk është e përshtatshme.

⁵ **Sekretariati i Komunitetit të Energjisë:** Ju lutem specifikoni referencat për organet e korporatës për OST, duke përfshirë kompetencat përkatëse, pasi të jetë bërë i ditur vendosja përfundimtare e korporatës për kompaninë OST.

zbatimin e Programit të Përputhshmërisë.

- 1.3. Kjo kontratë do të konsiderohet si kontratë tregëtare për ofrimin e shërbimeve të mbyllura sipas termave dhe kushteve të vendosura në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë dhe akteve të tjera ligjore në fuqi. Dispozitat e përgjithshme që rregullojnë marrëdhëniet civile dhe tregëtare midis Palëve duhet të aplikohen në Kontratë pa dëmtuar zbatimin e kërkesave specifike të krijuara me Ligj.
- 1.4. Në rastet kur Zyrtari i Përputhshmërisë punësohet nga OST për ofrimin e shërbimeve sipas kësaj Kontrate, kontrata e punësimit midis OST dhe Zyrtarit të Përputhshmërisë duhet të përputhet plotësisht me dispozitat e kësaj kontrate dhe nuk duhet të vendosë kufizime në statusin dhe/ose aktivitetet e Zyrtarit të Përputhshmërisë ose të vendosë përjashtime nga të drejtat dhe/ose detyrimet e palëve si është rrënë dakord në këtë dokument.⁶

2. KUALIFIKIMET DHE PAVARËSIA E ZYRTARIT TË PËRPUTHSHMËRISË

- 2.1. Zyrtari i Përputhshmërisë duhet të përmbushë kërkesat minimale për kriteret profesionale dhe kriteret e tjera përzgjedhëse të vendosura nga OST [*organi përkatës*] dhe miratohen nga ERE dhe që janë zbatuar për përzgjedhjen e Zyrtarit të Përputhshmërisë. Zyrtari i Përputhshmërisë duhet të plotësojë kriteret profesionale dhe kriteret e tjera përzgjedhëse gjatë periudhës së vlefshmërisë së Kontratës. Kriteret profesionale dhe kriteret e tjera përzgjedhëse, të vendosura nga OST [*organi përkatës*] dhe të miratuara nga ERE, duhet të bashkëngjiten në [Shtojcën II] të kësaj Kontrate.
- 2.2. Zyrtari i Përputhshmërisë duhet të jetë i pavarur gjatë ofrimit të shërbimeve për OST. Pavarësia e Zyrtarit të Përputhshmërisë duhet të sigurohet për gjatë gjithë vlefshmërisë së Kontratës dhe me mbarimin e saj, si specifikohet këtu dhe më poshtë, me aplikimin e kërkesave të mëposhtme:
 - 2.2.1. Zyrtari i Përputhshmërisë nuk duhet të kryejë asnjë detyrë tjetër profesionale dhe nuk duhet të lejohet që në mënyrë të drejtpërdrejtë ose tërthore të kryejë ndonjë funksion tjetër apo të marrë pjesë në biznese ose të jetë partner biznesi me ndonjë pjesë të kompanisë vertikalisht të

⁶ **Sekretariati I Komunitetit të Energjisë:** Kjo dispozitë, duke iu referuar marrëdhënieve të mundshme të punësimit midis OST dhe Zyrtarit të Përputhshmërisë, mund të hiqet në rastin kur kjo kontratë mbyllet me një person juridik i cili ofron shërbimet e Zyrtarit të Përputhshmërisë.

integruar ose me shumicën e aksioneve të saj, ose me çdo kompani të lidhur në aktivitetin e gazit natyror përveç transmetimit të gazit natyror (duke përfshirë edhe operatorin e kombinuar, sipas rastit);

2.2.1.1. gjatë periudhës së vlefshmërisë së Kontratës;

2.2.1.2. për një periudhë prej të paktën 3 (tre) vjet para përfundimit të Kontratës; dhe

2.2.1.3. me përfundimin e kësaj Kontrate, për një periudhë prej të paktën 4 (katër) vjetësh;

2.2.2. Zyrtari i Përputhshmërisë nuk duhet të ketë interes ekonomik ose të marrë përfitime financiare, që në mënyrë të drejtpërdrejtë ose tërthore, nga kompanitë vertikalisht të integruara ose ndonjë pjesë e tyre, ose nga kompanitë që kanë lidhje me aktivitetin e gazit natyror, përveç transmetimit të gazit natyror (duke përfshirë operatorin e kombinuar, sipas rastit).

2.3. Zyrtari i Përputhshmërisë duhet të refuzojë çdo udhëzim ose kërkesë të OST, organeve korporuese, të drejtuesve, punonjësve dhe/ose çdo përfaqësuesi tjetër që është ose mund të jetë në konflikt me mandatin dhe/ose pavarësinë e Zyrtarit të Përputhshmërisë.

2.4. Në rastet kur statusi i kërkuar i pavarësisë, kriteret minimale profesionale dhe/ose kriteret e tjera përzgjedhëse ndryshojnë gjatë vlefshmërisë së kësaj Kontrate, Zyrtari i Përputhshmërisë duhet të informojë në kohë por jo më vonë se dita tjetër e punës pasi është vënë në dijeni për këtë ndryshim, Drejtuesin e Përgjithshëm të OST për ndryshimin dhe të ofrojë shpjegime me shkrim që arsyetojnë dokumentacionin dhe kur është e nevojshme të ofrojë zgjidhje për ta korrigjuar.

2.5. Në rastin referuar në Paragrafin 2.4, Zyrtari i Përputhshmërisë duhet të tërhiqet përkohësisht nga pozicioni i tij derisa [*organi përkatës*] i OST të marrë vendimin për bashkëpunim të mëtejshëm me Zyrtarin e Përputhshmërisë ose të aplikojë në ERE për miratimin e përjashtimit të Zyrtarit të Përputhshmërisë. Kur është e nevojshme, [*organi përkatës*] i OST mund të konsultohet me ERE para se të marrë vendimin.

- 2.6. Mosplotësimi nga Zyrtarit i Përputhshmërisë i kërkesave për kualifikimin e tij dhe/ose pavarësinë specifikuar në Pjesën 2 konsiderohet si shkelje e kësaj Kontrate.

3. SHËRBIMET E ZYRTARIT TË PËRPUTHSHMËRISË

- 3.1. Zyrtari i Përputhshmërisë ka për detyrë monitorimin e zbatimit të Programit të Përputhshmërisë dhe për raportimin e këtij zbatimi sipas termave dhe kushteve të përcaktuara në Ligj dhe tek Programi i Përputhshmërisë. Veçanërisht, Zyrtari i Përputhshmërisë duhet të ofrojë shërbimet e mëposhtme:⁷
- 3.1.1. monitorim të vazhdueshëm për zbatimin e Programit të Përputhshmërisë;
 - 3.1.2. përpunimin e një raporti vjetor, ku përcaktohen masat që do të merren për zbatimin e Programit të Përputhshmërisë dhe dorrëzimi i këtij raporti në ERE dhe tek Sekretariati i Komunitetit të Energjisë brenda afateve të përcaktuara në Programin e Përputhshmërisë;
 - 3.1.3. raportim i vazhdueshëm në organet përkatëse të kompanisë OST dhe nxjerrja e rekomandimeve për Programin e Përputhshmërisë dhe zbatimin e tij;
 - 3.1.4. investigim dhe raportim tek organet përkatëse të OST për shkeljet e pretenduara në lidhje me zbatimin e Programit të Përputhshmërisë, dhe paraqitjes së zgjidhjeve të propozuara për masat e nevojshme korrigjuese;
 - 3.1.5. investigim i konfliktit të mundshëm ose ekzistues të interesit për drejtuesit dhe punonjësit e OST, ofrimi i konsultimeve në lidhje me parandalimin e konflikteve të mundshme ose korrigjimin e konflikteve ekzistuese të interesit, si dhe ofrimin e zgjidhjeve të propozuara për masat e nevojshme korrigjuese;
 - 3.1.6. të informojë ERE për shkeljet në lidhje me zbatimin e Programit të Përputhshmërisë;

⁷ **Sekretariati i Komunitetit të Energjisë:** Shërbimet (detyrimet) e Zyrtarit të Përputhshmërisë të përcaktuara në Paragrafin 3.1 shkruhen në përputhje me draftin e Programit të Përputhshmërisë (drafti fillestar i Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë datë 7 Dhjetor 2016). A duhet të ndryshohet draft Programi i Përputhshmërisë, ju lutem pasqyroni ndryshimet në këtë draft Kontratë.

- 3.1.7. raportim në ERE për marrëdhëniet tregëtare dhe/ose financiare midis OST dhe kompanive vertikalisht të integruara ose ndonje pjese të tyre;
- 3.1.8. ndjekja e takimeve të organeve përkatëse të OST dhe kur është e përshtatshme konsultimi i pjesëmarrësve në takime për kërkesat e Programit të Përputhshmërisë, në rastet kur takimet trajtojnë çështjet e mëposhtme:
- 3.1.9.
- 3.1.9.1. kushtet për aksesin në sistemin e transmetimit dhe përdorimin e rrjetit të transmetimit, në veçanti në lidhje me çmimet dhe shërbimet për të patur akses në sistemin e transmetimit dhe përdorimin e rrjetit të transmetimit, si dhe në lidhje me alokimin e kapaciteteve dhe menaxhimin e kongjestioneve, transparencën, balancimin dhe tregjet dytësore;
- 3.1.9.2. projektet e ndërmarra për të menaxhuar sistemin e transmetimit dhe për të mirëmbajtur e zhvilluar rrjetin e transmetimit, përfshirë investimet në linjat ndërkufitare të interkoneksionit dhe lidhjet; dhe
- 3.1.9.3. blerjet ose shitjet e energjisë të nevojshme për funksionimin e sistemit të transmetimit, përfshirë shërbimet ndihmëse dhe shërbimin e balancimit.
- 3.1.10. paraqitja e propozimeve për organet përgjegjëse të OST, sipas miratimit paraprak nga ERE në lidhje me planin 10-vjeçar për zhvillimin e rrjetit të transmetimit ose investimeve individuale në rrjetin e transmetimit;
- 3.1.11. activities; monitorimi i përputhshmërisë së OST me dispozitat e Ligjit dhe Programit të Përputhshmërisë duke rregulluar konfidencialitetin në aktivitetet e kompanisë OST;
- 3.1.12. monitorimi i ndryshimeve legjislative dhe rregulatore në lidhje me aplikimin dhe zbatimin e Programit të Përputhshmërisë;
- 3.1.13. ofrimi i konsultimeve në lidhje me hartimin dhe miratimin e akteve të brendshme të kompanisë OST dhe pasqyrimi i ndryshimeve ligjore dhe

rregullatore në këto akte;

- 3.1.14. zhvillimi, mirëmbajtja dhe monitorimi i listës së autorizimeve aktive për akses në transaksionet ose aksionet online (duke përfshirë aksesin në bazën e të dhënave të kompanisë OST) duke paraqitur një rrezik shpërndarje të informacionit të ndjeshëm tregtar në pronësi të OST;
 - 3.1.15. përgjigja e pyetjeve të drejtuesve dhe punonjësve të OST në lidhje me Programin e Përputhshmërisë;
 - 3.1.16. udhëzimi i drejtuesve dhe punonjësve të OST për Programin e Përputhshmërisë, zbatimin e tij dhe kur është e përshtatshme ndryshimet e tij;
 - 3.1.17. kordinim i komunikimit me ERE, autoritetet e tjera përkatëse, pjesëmarrësit e tregut të gazit natyror dhe/ose palë të tjera të treta në lidhje me zbatimin e Programit të Përputhshmërisë.
- 3.2. Listën e shërbimeve të ofruara nga Zyrtari i Përputhshmërisë, të caktuara në Paragrafin 3.1, duhet të konsiderohen si fundore. Çdo shërbim tjetër mund të përfshihet vetëm nëse iu referohet qartë dispozitave të Ligjit ose Programit të Përputhshmërisë duke ndryshuar këtë Kontratë.
 - 3.3. Zyrtari i Përputhshmërisë, ndërkohë që ofron shërbimet e tij tek OST, duhet të jetë i lidhur nga detyrimet konfidenciale njësoj si drejtuesit dhe punonjësit e kompanisë OST të vendosura sipas Programit të Përputhshmërisë. Detyrimet konfidenciale duhet të jenë plotësisht të vlefshme gjatë gjithë mandatit të Zyrtarit të Përputhshmërisë dhe për një periudhë prej 4 (katër) vjetësh pas përfundimit të Kontratës. Mosplotësimi nga Zyrtari i Përputhshmërisë të detyrimeve konfidenciale do të konsiderohet si prishje e kësaj kontrate.
 - 3.4. Të gjitha rezultatet e shërbimeve të ofruara nga Zyrtari i Përputhshmërisë sipas Paragrafit 3.1 duhet të paraqiten me shkrim ose me gojë, si kërkohet nga shërbimet përkatëse, derisa të kërkohet një formë specifike nga Zyrtari i Përputhshmërisë sipas Programit të Përputhshmërisë ose kësaj Kontrate.
 - 3.5. Të gjitha dokumentat e përgatitura nga Zyrtari i Përputhshmërisë duhet të jenë në gjuhën Shqipe. Raporti vjetor i zhvilluar nga Zyrtari i Përputhshmërisë duhet të përkthehet në gjuhën Angleze pasi duhet të paraqitet në Sekretariatën e Komunitetit të Energjisë.

4. TË DREJTAT E ZYRTARIT TË PËRPUTHSHMËRISË

- 4.1. Për tu përputhur me detyrimet për ofrimin e shërbimeve për kompaninë OST sipas Paragrafit 3.1, Zyrtari i Përputhshmërisë duhet të ketë të drejtën për të:⁸
- 4.1.1. kërkuar kushtet e duhura financiare dhe organizuese që i mundësojnë Zyrtarit të Përputhshmërisë ofrimin e shërbimeve në mënyrë eficiente;
 - 4.1.2. kërkojë bashkëpunim me drejtuesit dhe punonjësit e OST kur është e nevojshme për zbatimin e Programit të Përputhshmërisë;
 - 4.1.3. ketë akses tek të gjitha të dhënat përkatëse dhe në zyrat e OST, dhe te informacioni i nevojshëm për të kryer detyrat e tij. Zyrtari i Përputhshmërisë duhet të ketë akses tek zyrat e OST pa njoftim paraprak;
 - 4.1.4. ketë akses te të gjitha kontaktet e lidhura nga OST me pjesëmarrësit e tjerë të tregut të gazit natyror, përdoruesit e rrjetit dhe palë të tjera të treta dhe te dokumentat origjinale (ofertat tregëtare, deklaratat e pranimit, memorandumet, faturat, *etj.*);
 - 4.1.5. të marrë pjesë tek të gjitha takimet e organeve përkatëse të OST, përveç atyre që iu jemi referuar në Paragrafin 3.1.8 ku Zyrtari i Përputhshmërisë është i detyruar që ti ndjekë;
 - 4.1.6. të marrë pjesë te të gjitha takimet e drejtuesve dhe punonjësve të OST, përfshirë takimet funksionale;
 - 4.1.7. të sigurojë opinionin e tij për dokumentat ose veprimet e brendshme të propozusra nga OST në lidhje me përputhjen e tyre me aktet ligjore në fuqi, përfshirë ndryshimet ligjore dhe rregullatore në fjalë, dhe me Programin e Përputhshmërisë.
- 4.2. Të drejtat e Zyrtarit të Përputhshmërisë të cilave nuk iu jemi referuar në Paragrafin 4.1, por që vijnë si pasojë e detyrimeve të vendosura tek Ligji dhe/ose

⁸ **Sekretariati i Komunitetit të Energjisë:** Të drejtat e Zyrtarit të Përputhshmërisë të përcaktuara në Paragrafin 4.1 janë shkruar në përputhje me draft Programin e Përputhshmërisë (drafti fillestar i Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë datë 7 Dhjetor 2016). A duhet që draft Programi i Përputhshmërisë të ndryshohet, ju lutem pasqyroni ndryshimet në këtë draft Kontratë.

Programi i Përputhshmërisë sipas nevojës për kryerjen sic duhet nga Nëpunësi i Përputhshmërisë dhe ofrimin e shërbimeve që duhet të përmbushen sipas pëlqimit reciprok midis Palëve.

- 4.3. Palët duhet të sigurojnë përmes bashkëpunimit reciprok që të gjitha të drejtat e Zyrtares të Përputhshmërisë janë plotësuar sic duhet në përputhje me objektivat e Programit të Përputhshmërisë.

5. TË DREJTAT DHE DETYRIMET E OST

- 5.1. Anëtarët e [*organit/ organeve përgjegjëse*] të OST dhe Drejtuesit e Përgjithshëm duhet të kenë të drejtën të kërkojnë nga Zyrtari i Përputhshmërisë të ofrojnë shërbimet në kohën e duhur dhe sipas termave dhe kushteve të vendosura në Ligj, tek Programi Përputhshmërisë dhe kjo Kontratë.
- 5.2. Organet përgjegjëse të OST të cilave iu jemi referuar në Paragrafin 5.1 në çdo kohë mund të kërkojnë nga Zyrtari i Përputhshmërisë të paraqesë shpjegime me shkrim ose raporte për sigurimin e shërbimeve dhe statusin e zbatimit të Programit të Përputhshmërisë.
- 5.3. OST, drejtuesit, punonjësit dhe ose përfaqësuesit e tjerë të autorizuar duhet të kenë të drejtën të paraqesin kërkesat tek Zyrtari i Përputhshmërisë në lidhje me aplikimin praktik dhe zbatimin e Programit të Përputhshmërisë.
- 5.4. OST, drejtuesit, punonjësit dhe/ose përfaqësues të autorizuar duhet të rruhen nga udhëzimet ose kërkesat, ose çdo veprim tjetër që mund të jetë në konflikt me mandatin dhe/ose pavarësinë e Zyrtares të Përputhshmërisë.
- 5.5. Për të siguruar kushtet e duhura për Zyrtaresin e Përputhshmërisë për të kryer detyrat dhe përmbushur të drejtat e tij sipas kësaj kontrate, OST është e detyruar:⁹
 - 5.5.1. ti ofrojë Zyrtaresin të Përputhshmërisë një zyrë të kompletuar me të gjitha pajisjet tek ambientet e OST dhe të sigurohet që Zyrtari i Përputhshmërisë ka të gjitha mjetet në zyrë (përfshirë kancelaritë, kompjuterin, pajisjet e komunikimit, etj.) si dhe mbështetjen administrative të nevojshme për ofrimin e këtyre shërbimeve;

⁹ **Sekretariati i Komunitetit të Energjisë:** Ju lutem specifikoni detyrimet e OST, a janë ato të nevojshme duke marrë parasysh tekstin përfundimtar të Programit të Përputhshmërisë që do të miratohet nga ERE.

- 5.5.2. të paguajë për shërbimet e ofruara nga Zyrtari i Përputhshmërisë si kërkohet në Pjesën 6;
 - 5.5.3. të udhëzojë drejtuesit dhe punonjësit për detyrimin për të bashkëpunuar me Zyrtarin e Përputhshmërisë si është e nevojshme për zbatimin e Programit të Përputhshmërisë. Ky detyrim duhet të tregohet qartë tek kontratat dhe/ose udhëzimet e drejtuesit/punonjësit të kompanisë OST;
 - 5.5.4. ti ofrojë Zyrtarit të Përputhshmërisë një akses të pakufizuar tek të gjitha të dhënat, kontaktet dhe tek zyrat e OST, si dhe të gjithë informacionin e nevojshëm për të kryer detyrimet e tij;
 - 5.5.5. të mbështesë Zyrtarin e Përputhshmërisë duke ofruar të dhëna, informacion dhe asistencë në kohën e duhur;
 - 5.5.6. të informojë Zyrtarin e Përputhshmërisë për takimet e programuara ose jo të organeve përkatëse të OST, të drejtuesve dhe/ose punonjësve, dhe të ofrojë të gjitha materialet e nevojshme për të marrë pjesë në këto takime. Ky informacion dhe materialet duhet të ofrohën në kohë para takimit;
 - 5.5.7. të përfshijë Zyrtarin e Përputhshmërisë në diskutime të planit dhjetëvjeçar për zhvillimin e rrjetit të transmetimit, hartimin e akteve të brendshme dhe çështjeve të tjera funksionale, si dhe ndryshimeve strukturore ose ato të korporatës të OST;
 - 5.5.8. të informojë Zyrtarin e Përputhshmërisë për ndonjë shkelje të pretenduar të Programit të Përputhshmërisë, konflikt ekzistues ose të mundshëm të interesit të drejtuesve dhe punonjësve të OST, shkelje të pretenduar të detyrimeve konfidenciale dhe çdo dukuri tjetër që mund të ketë efekt në zbatimin e Programit të Përputhshmërisë.
- 5.6. Detyrimet të cilave iu jemi referuar në Paragrafin 5.5 duhet të kryhen nga Drejtori i Përgjithshëm i kompanisë OST ose drejtuesit ose punonjësit (përkatësisht drejtoret e drejtorive dhe përgjegjësat e sektorit) sipas kompetencave dhe mandatit të tyre. Çdo drejtues ose punonjës i OST duhet të ketë të drejtën që ti referohet Zyrtarit të Përputhshmërisë në lidhje me zbatimin e Programit të Përputhshmërisë dhe është i detyruar të raportojë çdo shkelje të pretenduar.

5.7. Të drejtat dhe detyrimet e OST të cilat nuk janë shprehur qartë në Pjesën 5, por që rrjedhin nga Ligji dhe/ose Programi i Përputhshmërisë sipas nevojës për një performancë në kohë nga Zyrtari i Përputhshmërisë duhet të plotësohet sipas pëlqimit reciprok midis Palëve.

6. PAGESA PËR SHËRBIMET E ZYRTARIT TË PËRPUTHSHMËRISË

- 6.1. Pagesa për shërbimet e ofruara nga Zyrtari i Përputhshmërisë nuk duhet të bazohen tek vlerësimi i performancës nga drejtuesit e OST. Zyrtari i Përputhshmërisë duhet të paguhet sipas termave dhe kushteve të Kontratës. Politikat e tjera të pagesës që aplikohet nga OST nuk duhet të ketë efekt tek pagesa për shërbimet e ofruara nga Zyrtari i Përputhshmërisë.
- 6.2. Pagesa mujore për shërbimet e Zyrtarit të Përputhshmërisë duhet të jetë [●] Lek.
- 6.3. Pagesa referuar në Paragrafin 6.2 duhet të jetë pa taksat dhe zbritje të tjera. Nëse kërkohet që ato të vendosen sipas akteve ligjore në fuqi, tatimet, taksat dhe zbritjet, përfshirë ato që kanë lidhje me punesimin, duhet të kompensohen të ndara nga OST.¹⁰
- 6.4. Të gjitha kostot e shkaktuara nga OST për shkak të kryerjes së detyrimeve të tij sipas Pjesës 5 do të përballohen nga OST dhe nuk do të kenë efekt te paga për shërbimet e ofruara nga Zyrtari i Përputhshmërisë.
- 6.5. Të gjitha pagesat e Zyrtarit të Përputhshmërisë duhet të kryhen çdo muaj jo më vonë se data 10 (dhjetë) e çdo muaji. Në rast se pagesa vonohet, OST është e detyruar të paguajë një kamatvonesë e cila është e barabartë me [0.02%] të pagesës së vonuar.

7. DETYRIMET FINANCIARE DHE ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

7.1. Palët janë të detyruara për zbatimin sic duhet të Kontratës sipas termave dhe kushteve të përcaktuara në Ligj, dhe për më tepër tek Programi i

¹⁰ **Sekretariati I Komunitetit të Energjisë:** Ju lutem specifikoni taksat ose detyrimet që kanë lidhje, nëse është e nevojshme.

Përputhshmërisë.

- 7.2. Në rast prishje të Kontratës, secila Palë mund të ankohet për humbjet direkte të cilat duhet të kompensohen nga Pala fajtore. Këto humbje duhet të llogariten dhe arsyetohen sipas termave dhe kushteve të vendosura në aktet ligjore në fuqi.
- 7.3. Të gjitha mosmarrëveshjet që rrjedhin nga kjo kontratë ose ato që kanë lidhje me zbatimin e saj duhet të zgjidhen në mënyrë shoqërore duke ndjekur konsultimet reciproke nga Palët.
- 7.4. Në rast se palët nuk e zgjidhin mosmarrëveshjen sipas Paragrafit 7.3, secila Palë ka të drejtën që të drejtohet në ERE për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, bazuar në vendimin për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, ose mund ti drejtohet gjykatës përkatëse të Republikës së Shqipërisë.
- 7.5. Të dyja Palët bien dakord, që për qëllim të kësaj kontrate duhet të përjashtohet gjykimi tregetar si formë e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve.

8. VLEFSHMËRIA E KONTRATËS

- 8.1. Kjo Kontratë hyn në fuqi në datën kur ajo miratohet nga ERE, si specifikohet edhe këtu. Mandati i Zyrtarit të Përputhshmërisë duhet të fillojë ditën tjetër të punës pas miratimit që i jemi referuar më sipër.
- 8.2. Kjo kontratë është e vlefshme për një periudhë prej 3 (tre) vjetësh nga data kur është miratuar nga ERE.
- 8.3. Të gjitha ndryshimet e Kontratës duhet të bëhen sipas marrëveshjes reciproke mes Palëve, *ndër të tjera* duke marrë parasysh ndryshimet ligjore. Çdo ndryshim në këtë kontratë në çdo kohë që ajo të hyjë në fuqi duhet ti nënshtrohet miratimit nga ERE.
- 8.4. Kjo kontratë mund të përfundojë para kohë, si specifikohet në Paragrafin 8.2, vetëm në rastet e mëposhtme:
 - 8.4.1. Me kërkesën e Zyrtarit të Përputhshmërisë e cila ndiqet nga njoftimi me shkrim i Drejtorit të Përgjithshëm të OST të paktën 2 (dy) muaj para datës së njoftuar për mbarimin e saj;

- 8.4.2. Me iniciativën e OST në rast se Zyrtari i Përputhshmërisë nuk plotëson kushtet e kualifikimit dhe/ose pavarësinë, si është vendosur në Ligj, tek Programi i Përputhshmërisë dhe tek kjo Kontratë; ose
- 8.4.3. Bazuar në marrëveshjen reciproke midis Palëve.
- 8.5. Në rastin e marrëdhënieve të punësimit midis OST dhe Zyrtarit të Përputhshmërisë, asnjë nga kushtet e lejurara nga Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë nuk mund të aplikohet për përjashtimin e Zyrtarit të Përputhshmërisë përveç pikave të përmendura në Paragrafin 8.4.¹¹
- 8.6. Para mbarrimit të mandatit, qoftë kjo për shkak të mbarrimit të vlefshmërisë së Kontratës ose mbylljes së parakohshme në përputhje me Paragrafin 8.4, Zyrtari i Përputhshmërisë duhet të përgatisë listën e dokumentave në zotërim të tij, arsyetimet e nevojshme me shkrim dhe raportin përfundimtar të aktiviteteve të tij të cilat do të dorëzohen Drejtorit të Përgjithshëm të kompanisë OST.
- 8.7. Vendimi për përfundimin e kësaj Kontrate dhe si pasojë, shkarkimi i Zyrtarit të Përputhshmërisë duhet të merret nga [*organi përkatës*] i OST duke shpjeguar qartë arsyet për përfundimin e kontratës dhe vendimi duhet të miratohet nga ERE.

9. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

- 9.1. Kjo kontratë duhet të drejtohet, ndërtohet, interpretohet dhe të zbatohet sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë.
- 9.2. Kontrata është bërë në gjuhën Shqipe, në 3 (tre) kopje njësoj kufizuese, nga një kopje për secilën prej Palëve dhe një kopje duhet të paraqitet në ERE.
- 9.3. Shtojcat më poshtë duhet ti bashkëlidhen Kontratës:
- 9.3.1. Shtojca I. Programi i Përputhshmërisë;
- 9.3.2. Shtojca II. Kriteret profesionale dhe kriteret përzgjedhëse të Zyrtarit të Përputhshmërisë.

¹¹ **Sekretariati i Komunitetit të Energjisë:** Kjo dispozitë, duke iu referuar marrëdhënieve të mundshme të punësimit midis OST dhe Zyrtarit të Përputhshmërisë, mund të hiqet në rast mbyllje të kësaj Kontrate me një person juridik i cili ofron shërbimet e Zyrtarit të Përputhshmërisë.

9.4. Me hyrjen në fuqi të kësaj Kontrate, Zyrtari i Përputhshmërisë duhet ti ofrojë Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë një kopje të Kontratës dhe shtojcave të saj në gjuhën Angleze.

10. KUSHTET E DOMOSDOSHME (REKUIZITAT) DHE NËNSHKRIMI NGA PALËT

10.1. Të gjitha komunikimet mes palëve duhet të përpunohen bazuar tek kontaktet e mëposhtme dhe te kushtet e domosdoshme (rekuizitat):

OST

[adresa]

[numri i telefonit, faksit dhe adresa e emailit]

Zyrtari i Përputhshmërisë

[adresa]

[numri i telefonit, faksit, adresa e emailit]

[llogaria bankare dhe detajet e bankës]

Në emër të kompanisë OST:

**Në emër të Zyrtarit të
Përputhshmërisë:**

Miratimi nga ERE:

Vendimi i Bordit të ERE Nr.78 datë 26.05.2017